

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada-Government**

MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
 MINISTARSTVO POLJPOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNIG RAZVOJA  
 MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT  
 ZYRA E MINISTRIT  
 KANCALARIJA MINISTRA  
 MINISTER'S OFFICE

**LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP**

<b>REFERENCË:</b>		REF. 12/54/08			
<b>PËR/ZA/TO:</b>		Ministrin e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural			
<b>CC:</b>					
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>					
<b>NGA/OD/FROM:</b>		Shefki Zeqiri- Drejtor i Departamentit ligjor			
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>		Përgjigje në Urgjencë			
<b>Nr. i zyrës:</b>	209	<b>Lokacioni:</b>	Departamenti ligjor	<b>Data:</b>	31/03/2008
<b>Br. kancelarije:</b>		<b>Kucni:</b>		<b>Datum:</b>	
<b>Room No.:</b>		<b>Extension:</b>		<b>Date:</b>	
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION					<input type="checkbox"/>
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL					<input checked="" type="checkbox"/>
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE					<input checked="" type="checkbox"/>
PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS					<input type="checkbox"/>
A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/MAY WE DISCUSS					<input type="checkbox"/>
VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/YOUR ATTENTION					<input type="checkbox"/>
SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED					<input type="checkbox"/>
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED					<input type="checkbox"/>
SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN					<input type="checkbox"/>
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION					<input type="checkbox"/>
<b>AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE</b>					

Z.Ministër,

Bashkangjitur, Ju dërgojmë Udhëzimin Administrativ NR. 9/2008 për Licencimin e aktiviteteve të Akuakulturës për miratim dhe nënshkrim.

Me respekt!

Fonti Book Antiqua: 16p, 13p,12p

Faqe 1 nga 1

Adresa: .....-10.000 Prishtinë-Kosovë

Telefon/Faks: + 377 44.....

<http://www.ks-gov.net/adresapërkatëse> E-mail: [adresapërkatëse@ks-gov.net](mailto:adresapërkatëse@ks-gov.net)



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

**MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**  
**MINISTARSTVO POLPJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNIG RAZVOJA**  
**MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT**

Bazuar në Rregulloren e UMNIK-ut nr. 2001/19 të datës 13 shtatorë 2001 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë neni 1.3 pika (d), nenin 65 paragrafi 1 pika (d) lidhur me nenin 25, 26, 28, 31, 33 të Ligjit për Peshkatari dhe Akuakulturë Nr. 2006/58 të datës 20 dhjetor 2006  
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Nxjerr:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 9/2008**  
**Për Licencimin e aktiviteteve të Akuakulturës**

**Neni 1**

**Qëllimi**

Me këtë Udhëzim Administrativ rregullohen kushtet të cilat duhet plotësuar personat fizik apo juridik për zhvillimin e aktiviteteve të Akuakulturës, formulari i kërkesës dhe procedura e dhënies së Licencës, forma e Licencës, forma dhe përmbajtja e Regjistrit të Licencave dhe Regjistri i regjistrimit të prodhimtarisë.

**Neni 2**

**Kushtet e Licencimit**

Licencën për zhvillimin e aktivitetit të akuakulturës e jep Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me kërkesë të personit fizik apo juridik, sipas kushteve të përcaktuara me nenin 25 të Ligjit për Peshkatari dhe Akuakulturë.

**Neni 3**

3.1 Personat fizik apo juridik të cilët aplikojnë për Licencë, përveç kushteve të përcaktuara si në nenin 2 të këtij Udhëzimi Administrativ, kërkesës duhet t'ia bashkëngjeshin:

- (a) dëshminë mbi pronësinë, apo dëshminë mbi qiranë të ngastrës kadastrale ku do të ndërtohet hurdha,
- (b) planin e ndërtimit të hurdhës,
- (c) lejen e ndërtimit nga organi kompetent i Komunës,

#### **Neni 4**

Personat fizik apo juridik të cilët aplikojnë për Licencë duhet të sigurojnë pëlqimin e banorëve të lokalitetit ku do të zhvillohet veprimtaria e akuakulturës.

#### **Neni 5**

##### **Forma dhe dokumentacioni përcjellës i kërkesës**

5.1 Kërkesës për licencimin e aktivitetit të akuakulturës i bashkëngjitet edhe dokumentacioni i përshkruar me nenin 26 të Ligjit për Peshkatari dhe Akuakulturë.

5.2 Forma e kërkesës është e paraqitur në aneXin 1 të këtij Udhëzimi Administrativ.

#### **Neni 6**

6.1 Komisioni për Licencim i shqyrton kërkesat dhe dokumentacionin dhe verifikon kriteret për zhvillimin e aktiviteteve të akuakulturës të përcaktuara me nenin 27 të Ligjit për Peshkatari dhe Akuakulturë dhe përpilon procesverbal me propozim për licencim.

6.2 Komisioni për Licencim, vendos në afat prej 60 ditëve pas datës së parashtrimit të kërkesës.

#### **Neni 7**

##### **Zgjedhja e Komisionit për Licencim**

7.1 Komisioni për Licencim përbëhet prej 5 anëtarëve:

- (a) 3/tre/përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,
- (b) 1/një/ përfaqësues nga Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor,
- (c) 1 /një/ përfaqësuesi nga Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinës .

7.1 Kryetar i Komisionit zgjidhet përfaqësuesi nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

#### **Neni 8**

##### **Forma dhe përmbajtja e Licencës**

Forma e licencës është e paraqitur në aneXin 2 të këtij Udhëzimi Administrativ në formë standarde A 4.

#### **Neni 9**

8.1 Formulari i licencës duhet të përmbajë tekstin në vazhdim::

- (a) Logon e Ministrisë,
- (b) Emërtimin e Ministrisë,
- (c) Numri i licencës,
- (d) Emërtimin e licencës,

- (e) Emrin e personit fizik apo juridik,
- (f) Adresa dhe selia e personit fizik apo juridik,
- (g) Numri i biznesit,
- (h) Sipërfaqja e hurdhës në ha,
- (i) Lloji i peshqve apo organizmave tjerë ujqor që mbarështohen,
- (j) Leja për shfrytëzimin e ujqit (sasia e ujqit),
- (k) Leja për shkarkimin e ujqit dhe
- (l) Nënshkrimi i ministrit dhe vula e ministrisë.

## **Neni 10**

### **Regjistri i Licencave**

10.1 Ministria mban Regjistrin e licencave i cili është i paraqitur në aneksin 3 të këtij Udhëzimi Administrativ.

10.2 Regjistri është i formës standarde A 4 me numër rendor dhe duhet të jetë i lidhur.

## **Neni 11**

11.1 Ministria në Regjistër mbanë këto të dhëna:

- a) Nr. rendor dhe data e regjistrimit,
- b) Nr. serik i licencës, data dhe vendi i licencimit,
- c) Të dhënat për hurdhën e licencuar,
- d) Të dhënat për personin fizik ose juridik që i është dhënë licenca,
- e) Vendimi për marrjen e licencës,
- f) Arsyeya për marrjen e licencës,
- g) Data e ngritjes së procedurës,
- h) Data e marrjes së vendimit nga gjykata kompetente,
- i) Data e zbatimit të procedurave administrative
- j) Vërejtje

## **Neni 12**

### **Taksa për licencë**

12.1 Personi fizik apo juridik për tu pajisur me licencë duhet të paguaj taksë.

12.2 Lartësia e taksës për licencë paguhet në shumën prej 1000,00 € sipas Udhëzimit Administrativ Nr.9/2004 Për Licencimin e Veprimtarive të Industrisë Ushqimore, jo Ushqimore dhe Ndërtimore dhe Çertifikimin e Produkteve të Industrisë Bujqësore.

12.3 Taksa për licencë paguhet në Buxhetin e Kosovës.

## **Neni 13**

### **Afati i vlefshmërisë së licencës**

13.1 Licenca për zhvillimin e aktiviteteve të akuakulturës vlen 10 vite, po qe se nuk parashihet ndryshe me Rregulla të veçanta për shfrytëzimin e ujërave.

13.2 Pas skadimit të afatit licenca duhet të ripërtërihet.

13.3 Kërkesa për vazhdimin e licencës bëhet së paku 60 ditë para skadimit të afatit të licencës.

## **Neni 14**

Në rast të zgjerimit të aktivitetit të akuakulturës personi fizik apo juridik është i obliguar të merr pëlqimin nga ministria.

## **Neni 15**

Personi fizik dhe juridik që posedon licencë është i obliguar të ofron të dhënat e sakta në ministri për mbarështimin e peshqve apo organizmave tjerë ujor.

## **Neni 16**

Të dhënat e ofruara shërbejnë për përcjelljen e gjendjes në akuakulturë dhe për hartimin e strategjive zhvillimore të nën sektorit.

## **Neni 17**

### **Tërheqja dhe pezullimi**

Licenca mund të tërhiqet apo pezullohet në rastet kur personi fizik apo juridik që merret me aktivitetet të akuakulturës e ndërron veprimtarinë, i skadon kontrata për shfrytëzimin e ujit, kultivon lloje të tjera të peshqve apo nuk i plotëson kriteret e parapara sipas nenit 27 të Ligjit për Peshkatari dhe Akuakulturë dhe këtij Udhëzimi Administrativ.

## **Neni 18**

### **Regjistri i prodhimitarisë**

18.1 Përmbajtja e regjistrit të prodhimitarisë në akuakulturë është i shtypur në format A 4 .

18.2 Formulari për regjistrimin e prodhimitarisë në akuakulturë është dhënë në Anexin 4 të këtij Udhëzimi Administrativ.

## **Neni 19**

19.1 Të dhënat për prodhimtarin i plotëson personi i autorizuar i subjektit të licencuar.

19.2 Personi i autorizuar mban përgjegjësi për saktësinë e të dhënave të ofruara.

## **Neni 20**

20.1 Të dhënat në regjistrin e prodhimitarisë në akuakulturë plotësohen dhe dorëzohen në ministri një herë në vit.

20.2 Të dhënat në regjistrin e prodhimitarisë përfshijnë periudhën prej 1 janarit gjerë më 31 dhjetor të vitit kalendarik paraparak.

20.3 Personi i autorizuar, të dhënat e sakta për prodhimtarin në akuakulturë, duhet ti dorëzoi në ministri më së voni gjer më 31 janar të vitit në vijim.

## **Neni 21**

### **Kontrolli dhe inspektimi**

Personat fizik apo juridik që merren me zhvillimin e aktiviteteve të akuakulturës, janë të detyruar që në çdo kohë t'i ofrojnë inspektorit të autorizuar, dokumentacionin e kërkuar për zhvillimin e aktiviteteve të akuakulturës.

## **Neni 22**

Mos zbatimi i këtij Udhëzimi Administrativ sanksionohet sipas nenit 59 pika (c) dhe (d) të Ligjit për Peshkatari dhe Akuakulturë.


## **Neni 23**

### **Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzimi Administrativ hynë në fuqi ditën e nënshkrimit .

Prishtinë, 31.03. 2008

Ministri i Ministrisë së Bujqësisë,  
Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural  
Idriz Vehapi



**Anexi 1.**



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
MINISTARSTVO POLPJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNIG RAZVOJA  
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

**KËRKESË PËR LICENCIMIN E VEPRIMTARISË SË AKUAKULTURËS**

**A. Subjekti** \_\_\_\_\_

Numri i biznesit \_\_\_\_\_ Adresa \_\_\_\_\_

Nr. i tel : \_\_\_\_\_

Fax : \_\_\_\_\_

Email : \_\_\_\_\_

**B. Lokacioni**

1. Përshkrimi i lokacionin, objektit/Vendi ku do te zhvillohet aktiviteti i akuakulturës:

\_\_\_\_\_

2. Pronësisë/Vendi:

Fleta poseduese: \_\_\_\_\_

Me qira/ Kontrata e bashkëngjitur \_\_\_\_\_

3. Plani i hurdhës/ i bashkëngjitur

4. Miratimet e marra ( plotëso katrorin nëse PO)

Leja e ndërtimit nga Komuna  Leja për shfrytëzimin e ujit  Leja e mbrojtëjes së ambientit , Leja për shkarkimin e ujit

**C. Lloji i peshkut apo organizmave tjerë ujore që do të mbarështohen dhe mënyra e kultivimit:**

1. Lloji i peshkut apo organizmave ujore (edhe ne gjuhen latine):

---

---

2. Dendësia e kultivimit ne  $\text{kg/m}^3$  (sipas llojit)

---

---

3. Prodhimtaria vjetore e planifikuar \_\_\_\_\_

4. Përshkrimi i burimit te ujit qe do te përdoret (Puse, burim, lumë ,etj )  
bashkëngjit planin:

5. Burimi i ujit ( Puse, burim, lume, rezervuar etj.) dhe sasia e ujit te propozuar  
(litër ne sekondë):

---

---

6. Detaje nga diga, basenet, liqeni etj. (numri, hapësira dhe thellësia)

---

---

7. Trajtimi i ujërave të përdorura pas shkarkimit:

---

---

8. Përshkrimi i objekteve përcjellëse (bashkëngjit planin)

9. Burimi i rasateve ( Nëse keni inkubator tuajin përshkruani detajet dhe teknikën e mbarështimit, ndërtesës, ëmat)

---

---

10. Origjina e peshkut qe do te kultivohet

Licenca: \_\_\_\_\_

Nr. Licencës: \_\_\_\_\_

11. Programi i ushqimit ( përshkrimi i sasisë vjetore te ushqimit si dhe metoda e dhënies se ushqimit )

---

---



12. Medikamentet apo kemikalet qe planifikohen te perdoren ne hurdhë  
(përshkrimi i medikamentit dhe sasia e përdorimit për një vit)

---

---

**Deklarata e Aplikantit:**

Unë/Ne deklarojmë se te dhënat ne ketë aplikacion si dhe dokumentacioni i bashkangjitur me Aplikacion janë te vërteta dhe te sakta.

---

---

Data: \_\_\_\_\_

Parashtruesi i kërkesës:

---

Anexi 2



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
MINISTARSTVO POLPJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNIG RAZVOJA  
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

**LICENCË PËR AKUAKULTURË**

Nr. \_\_\_\_\_

---

**Emri i subjektit (Hurdhës se peshkut)- Emri i personit juridik**

---

**Adresa dhe selia e subjektit**

**Nr. i biznesit** \_\_\_\_\_

**Siperf. e hurdhës/ ha** \_\_\_\_\_

**Lloji i peshqve apo organizmave tjerë ujor** \_\_\_\_\_  
(emërtimi latin)

**Sasia e ushqimit që do të përdoret** \_\_\_\_\_

**Nr. i lejes për shfrytëzimin e ujit** \_\_\_\_\_

**Nr. i lejes për shkarkimin e ujit** \_\_\_\_\_

**Nr. i lejes së mbrojtjes të ambientit** \_\_\_\_\_

**Licenca vlen deri** \_\_\_\_\_

**Data e licencimit**

**Vula**

**Nënshkrimi i ministrit**

---

---

Anexi 3.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
MINISTARSTVO POLPJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNIG RAZVOJA  
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

**REGJISTËR**  
**I LICENCAVE TË APROVUARA PËR AKUAKULTURË**

Në këtë regjistër janë  
Nr. rendor prej \_\_\_\_\_  
Permbyllet me nr. rend \_\_\_\_\_

## REGJISTRI I LICENCAVE TË APROVUARA PËR AKUAKULTURË

Nr. ren.i regjistrimit \_\_\_\_\_, faqja \_\_\_\_\_

Numri rendor i regjistrimit dhe data e regjistrimit	Numri serik i licencës, data dhe vendi i dhënies së licencës	Të dhënat e hurdhës për të cilën është dhënë licenca	Të dhënat e personit fizik apo juridik që i është dhënë licenca		
1	2	3	4		
Nr Rend. _____  Data : _____	Nr. serik i licen: <hr/> Data: _____  Vendi : _____	<hr/> Regjioni i peshkimit  Lloji i peshqve apo organizmave tjerë uJOR  Siperfaqja e hurdhës ha/volumi i kafazeve në m <sup>3</sup>	<hr/> Emri i Subjektit  Adresa e selisë  Nr. i biznesit		
Vendimi për marrjen e licencës	Arsyeja e marrjes së licencës	Data e ngritjes së procedurës	Vendimi i gjykatës dhe data e marrjes së vendimit	Data e zbatimit të vendimit administrativ	
				Përmbyllja e licencës	Zbatimi i dhunshëm
5	6	7	8	9	10
Nr serik i licencës _____  Data: _____					

**Vërejtje:**



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
MINISTARSTVO POLJPOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNIG RAZVOJA  
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

**FORMULARË PËR REGJISTRIMIN E PRODHIMTARISË NË  
AKUAKULTURË**

Viti \_\_\_\_\_

Nr. i formularit \_\_\_\_\_

Personi Juridik/fizik \_\_\_\_\_

Nr. dhe data e licencës \_\_\_\_\_

Vendi ku zhvillohet Aktiviteti \_\_\_\_\_

Sipërfaqja e hurdhës \_\_\_\_\_

Prodhimi total vjetor \_\_\_\_\_

Prodhimi sipas llojeve \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_

Prodhimi i të vegjëlve sipas llojeve \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_

Veçë/Ikra \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_

Larva \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_

Rasate \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_

Prodhimi i peshkut për konsum sipas llojeve në T \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_,  
\_\_\_\_\_

Numri i të punësuarve \_\_\_\_\_

Personi i autorizuar  
\_\_\_\_\_